
Lushnje, më 11/04/2021

KALLËZIM PENAL

KALLZUES: PARTIA DEMOKRATIKE DEGA LUSHNJE

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale "Shpërdorim i detyrës",
parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal, *Neni 328*
"Dhenia e shperblimeve dhe e premtimeve".

KUNDER: 

DREJTUAR: PROKURORISË PRANE GJYKATES SE SHKALLES SË PARE
LUSHNJE

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280, 283 të K.Pr.Penale, si dhe nenit 328 dhe 248 të Kodit Penal, parashtrajmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 dhe dispozitat tranzitore e tij parashikon se:

Neni 280

Marrja dijani për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.

Neni 283

Kallëzimi nga ana e shtetasve